



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0408
Data e Vendimit: 02.07.2026

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit ekonomik (OE) “FST Engineering SH.P.K.” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore - Ritenderim” me numër të prokurimit 623-26-4297-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Rahovec., Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Ardian Behra me datën 01.07.2026, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si e palejuar, ankesa e OE FST Engineering SH.P.K., me nr. të protokollit 2026/0408, e datës 22.06.2026, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore - Ritenderim” me numër të prokurimit 623-26-4297-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) - Kuvendi Komunal Rahovec.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues – Kuvendi Komunal Rahovec., që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore - Ritenderim” me numër të prokurimit 623-26-4297-2-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik e-prokurimi me datë 22.06.2026, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE FST Engineering SH.P.K., për aktivitetin e prokurimit; “Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore - Ritenderim” me numër të prokurimit 623-26-4297-2-2-1, inicuar nga Kuvendi Komunal Rahovec, në cilësinë e autoritetit kontraktues.

Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka

kryer pagesën siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së dhe nenin 69 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Nisur nga fakti se ankuesi, në ankesën e lartcekur, nuk i ka bashkëngjitur konfirmimin bankar për pagesën e tarifës së ankesës, edhe pse Zyra për Pranimin e Ankesave, më datë 23.06.2026, përmes email-it e ka njoftuar operatorin ekonomik ankues se, pas ekzaminimit të shkresave të bashkëngjitura në platformën e OSHP-së, është konstatuar se nuk është kryer pagesa e tarifës në përputhje me paragrafin 2 të nenit 69 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Në njoftim është cituar neni 69.2 i Rregullores, sipas të cilit:

"Në përputhje me nenin 118 të LPP-së, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë tarifën e ankesës në OSHP. Kur ankesa ndërlihet me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit ose shpërblimin e kontratave me çmime njësi (çmime të peshuara), shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një për qind (1%) të vlerës së parashikuar të kontratës, por jo më pak se 200 euro dhe jo më shumë se 10,000 euro."

Njëkohësisht, ankuesi është ftuar që, brenda afatit të mbetur ligjor, të përcjellë dëshminë për pagesën e tarifës së ankesës, duke u njoftuar se, në të kundërtën, ankesa do të refuzohet si e paplotë.

Ndërsa sqarojmë se OE ankues FST Engineering SH.P.K., lidhur me emailin e dërguar nuk ka kthyer përgjigje lidhur me emailin e dërguar nga OSHP.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE FST Engineering SH.P.K., e datës 22.06.2024 (protokoll 0408/2026), për aktivitetin e prokurimit me titull "Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore - Ritenderim" me numër të prokurimit 623-26-4297-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Rahovec, konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në këtë fazë duke e hedhur të njëjtën si të palejuar- jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

I lejohet, autoritetit kontraktues – Kuvendi Komunal Rahovec, që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore - Ritenderim" me numër të prokurimit 623-26-4297-2-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë OSHP i vë në dijeni AK, se në çdo aktivitet duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 të LPP-së.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Ardian Behra
Kryesues i Sekretariatit

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - FST Engineering SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: